

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Sekretari i këshillit bashkiak bën apelin. Marrin pjesë 43 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

*Pika e parë miratimi i rendit të ditës.*

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e dytë miratimi i proçesverbalit të mbjedhjes të muajit Janar (dt.26.01.2024).*

Këshilli Bashkiak me 38 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 3 dhe 3/1 e rendit të ditës.*

*3.Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë Elbasan për muajin Janar 2024.*

*3.1 Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2024.*

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro, 1 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

V.O (Vota kundër E.Muzhaqi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 4 dhe 5 e rendit të ditës.*

*4.Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë Elbasan për vitin 2024.*

*5.Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për vitin 2024.*

### **Aurora Domni- anëtare e Këshillit Bashkiak**

Donim të denim ndarjen e kategorive që marrin pjesë, siç është parashikuar tek ligji 57/2019. Tek këto familjet që marrin ndihmë ekonomike na i ndani dot me kategori, sa janë të dhunuara, kaq janë me ndihmë ekonomike sepse janë me fëni të shumë?

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kërkoni informacion më të detajuar?

### **Aurora Domni- anëtare e Këshillit Bashkiak**

Po. Ndarje të kategorive.

### **Doris Madhi - anëtare e Këshillit Bashkiak**

Në mënyrë të kategorizuar e kemi kërkuar që në Nëntor. Kemi bërë një shkresë. Shkresa ka përmbajt disa pika, janë preferencial apo janë të merituar. Jemi të sigurt që ju ka ardhur shkresa pasi e kemi marrë të firmosur. Kjo është dhe arsyeja pse ne sot po votojmë kundër kësaj skeme sepse ne nuk kemi informacion mbi këtë skemë, kush janë përfituesit e saj, pse e përfitojnë këtë ndihmë, sa ka ndryshuar numri, janë kërkuar të gjithë këto informacione.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Di që ka pas një kërkesë nga grupi juaj dhe është marrë një përgjigje. Kishte të bënte me numrin e ndryshëm nga zgjedhjet. Do ta kërkoj shkresën dhe do t'ju jap.

**Doris Madhi - anëtare e Këshillit Bashkiak**

Jo nuk është marrë shkresa. Para shkresës për inceneratorin është bërë një shkresë tjetër që është kërkuar i gjithë detajimi i ndihmës ekonomike. Ju është kërkuar për një vit, që nga Janari.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

E marr përsipër që do t’jua vë në dispozicion deri sot në drekë.

E hedhim në votim.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, 3 kundër, - abstënim, miraton sa më sipër.

V.O (Vota kundër A. Domni, E. Muzhaqi, D. Madhi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 6 e rendit të ditës.*

#### ***6.Monitorimi i buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2023.***

### **Shefqet Bullari – anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Monitorimi është bërë mbi bazën e ligjit për vetqeverisjen vendore dhe ligjit për financat e vetqeverisjes vendore, dhe ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Është analizuar çdo zë i realizimit të të ardhurave , i detajuar,dhe të 27 programet. Gjithashtu janë pasqyruar dhe shpenzimet e vitit në çdo zë. Janë pasqyruar investimet e bëra gjatë vitit. Ky është një raport i gjatë dhe shërben për të bërë ndryshimet përkatëse dhe për të rritur performancën e bashkisë. I ftoj anëtarët e këshillit ta miratojnë.

Këshilli Bashkiak me 38 vota pro, kundër, abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 7 e rendit të ditës.*

*7. Mbi miratimin e kontratës së “Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan” në impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë ECO-ELB sh.a midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë ECO-ELB sh.a.*

### **Shefqet Bullari – anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Kjo kontratë mbështetet në ligjin për vetqeverisjen vendore. Shoqëria Eco-Elb është krijuar si shoqëri me kapital të përbashkët të ashkive të qarkut Elbasan. Pas vendimit të Gjykatës së Posaçme u vu në sekuestrim, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata. Kjo shoqëri me kontratë qeraje ja ka dhënë Eco-Elb, me qëllim përpunimin e mbetjeve urbane. Në këto kushte bashkitë kanë lidhur me Eco-Elb kontrata për përpunimin e mbetjeve komfort çmimit. Janë përcaktuar të gjitha detyrimet e palëve në kontratë për të menaxhuar këtë impiant. I ftoj të gjithë anëtarët e këshillit për miratim.

### **Bjanka Copja- anëtare e këshillit bashkiak.**

Ne kemi kërkuar informacion shtesë. Nuk e di pse është kaq e vështirë të vij informacioni nga ju, aq më tepër nga Bashkia Elbasan që është aksioneri më i madh i inceneratorit. Për çfarë u shty kur nuk erdhi asnjë informacion shtesë. Në dijeninë time as komisioni nuk është mbajtur ditën e hënë. Bashkia ka për detyrë të bëjë një kontroll. Dua të di a është mbajtur një raport për vitin 2023. Nuk e di pse e shtyni për kaq kohë një informacion që e keni të gatshëm. Nuk është prona juaj, është për të mirën e të gjithë qytetarëve. Ne këtu jemi për qytetarët e Elbasanit. Ju lutem pak korrektësi. Minimumi është raporti vjetor për 2023, që ka Bashkia Elbasan si aksioneri më i madh, mbi punën që ka bërë Eco- Elb sh.a.

### **Aulona Bylykbashi – Nënkrjetare e Bashkisë Elbasan**

Përshëndetje. Duhet që ti referohem mbledhjes së kaluar ku ju Bjanka iu referuat një shkresë që unë nuk e kisha përpara, sepse ishte një shkresë e hartuar nga inceneratori, ne jemi njhur sapo jemi kthyer në institucion, dhe më vjen keq që po në vrazhën e informacioneve disinformuese ju thoni që nuk keni marr informacion. Ju i jeni drejtuar Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Elbasan me një shkresë për të cilën keni marr përgjigje me dokumentacion të plotë, dhe këtë mund t'ju verifitojmë sepse përveçse jua kemi nisur shkresën në formë zyrtare, jua kemi dërguar dhe me e-mail, ju është dërguar dhe mesazh që ju është nisur me e-mail, dhe i gjithë dokumentacioni është i plotë. Ju keni kërkuar herën që shkoi një analizë me kostot e operimit, unë e kuptoj që ju përgjigjet nuk ju vin komode për të bërë më pas referencat tuaja dhe këtë herë dalim me një referencë të rradhës që nuk është më analiza e kostos por tani është raporti financiar. Sot keni dal me një pretendim që nuk është i shkruar askund që është raporti financiar, megjithatë bashkia e disponon dhe këtë raport, nëse ju dëshironi mund ti drejtoheni me një shkresë të rradhës këtë kërkesë që jus apo e ngritët dhe mund ta keni në mbledhjet në vazhdim. Ajo që duhet në raport me kostot ju është vënë në dispozicion dhe ju lutem unë jam shumë dakord të diskutojmë për të mirën e qytetarëve por mos të disinformojmë.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Para disa ditësh u dërgua një kërkesë nga grupi i BF, bashkëpunuam me inceneratorin iu dha përgjigje me shkrim. Z. Eugen e ka marrë një përgjigje para disa ditësh. Të thuash bëra një kërkesë dhe nuk ka ardhur përgjitha nuk është e drejtë. Ju atë që keni kërkuar me shkrim e keni marr.

### **Doris Madhi – anëtare e këshillit bashkiak**

Informacionin e kam këkuar unë dhe Blendi Himçi dhe informacioni ka ardhur për mua dhe për Blendin. E mira është të shpëndahet tek të gjithë kur kërkohet nga një këshilltarë. Nga informacioni mbi analizën e kostos së incenerimit vërej që shoqëria pret 140 ton mbetje ditore dhe nga këto inceneron vetëm 90. Do të thotë që 50 ton mbetje ngelen. Pyetja e parë që më lind mua është sa ditë ka punuar inceneratori në 2023 dhe ku janë depozituar këto tonët e pa-inceneruara. Vërej që është mbledhur këshilli mbikqyrës i shoqërisë në 2023, është bërë një analizë kostoje me çmimet e referencës së 2022 dhe sot që jemi në 2024 vazhdojmë i referohemi 2022. Po ju marr vetëm një artikull, sepse dje nuk e pata kohën për ti parë të gjithë artikujt. Lënda që ne e kemi para syve është nafta. Është me çmim reference në 2022, 205 lekë pa TVSH, sot është 185 lekë pa TVSH. Si mbledhet



Këshilli mbikqyrës në 2023 me çmime të 2022, ndërkohë sot po bëhet kontrata e 2024. A keni bërë ju në 2023 kontrata, a bëi ju studim tregu. Nga ana tjetër bashkia është kontrolluesi kryesor. Për pjesën e prodhimit, janë 75 mega vat, por nuk mund të bëj inxhinieren. Nga ana tjetër na sillni të njëjtën kontratë, kur do rregullohen këto. Qytetarët e Elbasanit meritojnë minimumin e mbrojtjes nga ana jonë. Të na jepet përgjigje sa dotë ka punuar inceneratori 2022-2023. Ku janë çuar këto 140 ton. Nuk po kap pjesën e pagave.

### **Ilirjan Sadiku – anëtarë i këshillit bashkiak**

Të vazhdojmë, kështu nuk mbarojm deri nesër.

### **Doris Madhi – anëtare e këshillit bashkiak**

Kam kërkuar dhe situacionin e mbetjeve që vin në incinerator, çfarë hyn dhe çfarë del, si i masni sepse një pjesë është e riciklueshme. Nuk po e kërkojmë vjetor, por na e jepni ditur. Pse nuk e kemi këtë informacion.

### **Erion Murataj – anëtarë i këshillit bashkiak**

Disa shqetësime qëndrojnë, çmimi i karburantit psh që është një nga lëndët themelore. Inceneratori dhe pse i ka kushtuar shumë Elbasanit deh është problematikë publike, i nevojitet, pikërisht për atë që ka shumë njerëz të sëmurë nga mbetjet. Transparenca duhet të jetë themeli i ndërveprimit dhe interesave qytetare. Kërkesa ime është të ketë në mënyrë të vijuar raport mbi mbarëvajtjen e këtij aseti. Në parim vota ime është pro. Do të doja të kishte një raportim të paktën tre mujor, për ne si këshill bashkiak, si mbrojtës i të interesave të qytetarëve. Shikoj që mekanizmi është rregulluar nga ana ligjore.

### **Ilirjan Sadiku – anëtarë i këshillit bashkiak**

Zoti kryetar ju lutem ose na përcaktoni një minutazh ose një rregullore për korrespondencën.

### **Blendi Himçi – anëtarë i këshillit bashkiak**

Së pari unë ju falenderoj sepse është çështje e rëndësishme, por sigurisht është një nga elementët që mbart shqetësim të madh, jo vetëm se është politikë por sigurisht mbi të gjitha shqaf një sërë problematikash që une kisha disa pyetje. Doja të dija analizën e kostos, pse është përcaktuar ky çmim për ton, cilat janë vlerat që është përcaktuar 25 Euro. Pse ka prodhur kaq pak energji. Ne po i referohemi 2022, 2023 nuk kemi asnjë informacion. Sa ditë ka punuar 2023. Sa është sasia stok e mbetjeve

urbane. Depozitohen përditë 140 ton, i bie që çdo ditë të kemi 50 ton më tepër. Vazhdohet të furnizohet. Pjesa tjetër është që djegësi ka dhe filtra, sa është energjia që harxhojnë filtrat. Dhe e fundit është në lidhje mmbetjet atë që inceneratori e ka përfunduar si djegje, mbetjet kancerogjene, ku depzitohen këto, a ka një procedurë teknike të posacme për këto mbetje, si menaxhohen nga kompania. Faleminderit.

### **Bukurosh Stafa- anëtarë i këshillit bashkiak**

Na ka ardhur për miratim kjo kontratë. Ne sot nuk jemi mbledhur për të diskutuar ecurinë, por kontratën, ne diskutojmë për çmimin, nëse propozojmë ta çojmë 24. Ne sot jemi të përgatitur për një material që na ka ardhur. Ato mbetje do të shkonin në Shkumbin. Situata nuk është perfekte por nëse keni propozime për çmimin ta diskutojmë, por sa punon inceneratori nuk është diskutim për ne.

### **Zamir Muzhaqi - anëtarë i këshillit bashkiak**

Kërkesat tona kanë qënë të qarta. Në bazë të atij informacioni të plotë mbi mbetjet dhe incenerimin e mbetjeve, ta miratojmë. Megjithatë unë po i referohem kontratës sesa çështjeve që ju i thoni politike. Parashikon lidhjen midis bashkisë Eco-Elb por harrojmë që bashkia është përfaqësuese e qytetarëve. Objekti i kësaj kontrate është trajtim dhe incenerim, por a ka incenerim? Unë besoj se nuk ka. Në 2023 është ndezuar apo jo një herë. Kjo kontratë nuk është as si kontratë qeraje shtëpie. Ka të drejtat e shoqërisë dhe të bashkisë. Afati është një vit, efektet nuk ndërpriten. Kjo kontratë nuk ndërpritet kur bëhet incenerimi. Nuk parashikohet që kur një nga objektet nuk ndërmerret, ndërpritet kontrata. Të drejtat dhe detyrimet që shoqëria duhet të punojë sipas standareteve. Janë 150 ton në ditë. Të gjithë e dim që atje është ngritur një mal me plehra, ka ndryshu vend inga Shkumbini. Kjo e pjesës lindore u bë njëherë emergjente. Gjëni zgjidhje dhe pastaj hajdeni me kontrata më të sakta.

### **Lumturi Hasa – anëtarë e këshillit bashkiak**

Muaji Tetor është muaji i kancerit të gjirit. Elbasani mban rekord kryesor. Nëse kjo kompani nuk i zbaton të gjitha detyrimet që ka në kontratë atëherë kemi nenin 11 përgjegjësi për shkelje, nëse nuk zbatohet neni 11 atëherë ndërpritet kontrata. Unë jam dakord që kjo kontratë të ekzistojë por jo të shkruaj të tjera dhe të zbatojë të tjera. Duhet respektuar të gjitha nenet që janë në këtë kontratë. Në të kundërt ndërprerje. Këto gjëra duhen parë më me detaje.

### **Administratori i shoqërisë Eco-Elb**

Përshëndetje të gjithëve. Inceneratori për vitin 2023 ka bërë djegje për rreth 7 muaj. Në lidhje me mbetjet që vijnë dhe nuk digjen patjetër që sasia është shumë e madhe, ashtu ka qenë dhe para se ta merrte bashkia. Në lidhje me problematikat që kemi pasur në lidhje me energjinë patjetër që janë, nuk punon aktualisht turbina, dhe për këtë i jemi drejtuar dhe institucioneve për të na ndihmuar dhe vazhdojmë punën normalisht. Në lidhje me hiret ato janë depozituar në landfill, kemi hapur gropa për depozitimin e tyre, kshu e kemi dhe kontratën që kemi me ministrinë përkatëse.

### **Aulona Bylykbashi – Nënkyetare e bashkisë Elbasan**

Besoj që të gjitha pyetjet që u bënë morën përgjigje. Në raport me cilësinë e hartimit të kontratës, kjo është një kontratë e hartuar nga specialist/jurist të fushës, kështu që besoj që është hartuar shumë mirë. Referencat që ju bët që nuk ndërpritet kam përshtypjen që juridikisht i keni lexuar gabim, është mirë që ta lexoni të gjithë nenin, sepse i jep kuptim të gabuar dhe të gjitha detyrimit dhe kushtet kontraktuale janë respektuar. Këshilli ka të drejtë që sa herë e shikon të nevojshme të thërrasë të gjithë drejtorët që shoqëria ka, për të dhënë një përgjigje në raport me objektin që ato kërkojnë. U bë e dyta herë që që mblidhet këshilli dhe diskutimet 90 % shkon për diskutime për impiantin e energjisë dhe nuk më duket fare e arsyshme sepse koha e të gjithë materialit është e nevojshme të kalojë e barazvlefshme në raport me rëndësinë që kanë dhe nëse duhet trajtuar kështu kjo çështje duhet të kërkojnë stafin e të gjithë inceneratorit në një interpelancë të posaçme dhe të marrin të gjithë përgjigjet që paraprakisht ti kërkojnë më shkrim. Ju lutem të menaxhojmë kohën në raport me rregullat ligjore të mbarëvajtjes së këshillit.

### **Doris Madhi – anëtare e Këshillit Bashkiak**

Do marrim marrim kohën që i duhet dhe mund të rrim këtu edhe gjithë ditën edhe gjithë natën. Pyetja është konkrete zoti administrator sa ton apo njësi tjetër ditore karton, letër, qelq apo alumin hyn në incinerator, dhe pyetja dytë duke u bazuar në të gjithë analizën kostos që unë iu referova a i meriton ky incinerator ato 717 milionë lek nga ana e bashkisë. Duke qënë se ditët e punës janë ato që ju raportuat? Faleminderit.

### **Aulona Bylykbashi – Nënkyetare e bashkisë Elbasan**

Të dhënat që kërkoni janë shumë teknike, nëse kërkohet le të bëhe një mbledhje me të gjithë stafin Teknik të inceneratorit. Të gjith e dimë që në proceset e punës një drejtor i një institucioni të di saktësisht sa është e detajuar çdo sasi që hyn. Ai është

një staf i gjerë që punon dhe gjithë secili përgjigjet për gjënë e vet në raport me atë që mbulon, kështu që nuk më duket e arsyeshme. Megjithatë të dhënat janë, siç e keni kërkuar do ta keni. Unë jam shumë dakord që Bashkia Elbasan ngaqë i ka dhënë të gjithë rëndësinë e duhur sot është kujdesur që këto mbetje të mos mbeten rrugëve por të shkojnë të përpunohen, kur flasim për këtë kontratën kemi parasysh edhe pjesën e depozitimit edhe pjesën e trajtimit, hallka që ju nuk i përmendni fare, por padyshim që ka dhe momente që inceneratori kalon dhe ka nevojë për riparime dhe pjesët e tjera të mirëmbajtjes, është një gjë teknologjike që ka nevojë dhe për këtë proces, kështu që unë mendoj që ta hedhim në votim sepse dhe diskutimet kryetar kanë rregulore të caktuar, kanë një kohë kanë një proces.

### **Erion Murataj – anëtarë i këshillit bashkiak**

Unë e kuptoj pjesën politike, por ne po diskutojmë sikur ne kemi zgjidhje tjetër, pra e ndërpresim kontratën por ku shkojnë këto mbetje?

### **Blendi Himçi – anëtarë i këshillit bashkiak**


Këtë ton sinqerisht më lë pa fjalë. Të mbyllësh këto lloj diskutimi me forcën e kartonit. Të lutem mos më ndërpre. Unë bëra disa pyetja, pyetjeve nënkryetarja pretendon se iu dha përgjigje, dhe sigurisht pas pyetjeve më lind e drejta të kem edhe fjalën time në lidhje me kaq sa u përgjigj administratori dhe nënkryetarja. Mos harrojmë që inceneratori do i jepte zgjidhje të gjithë qarkur të Elbasanit për mbetjet urbane dhe investimi që bëri në atë kohë firma me të ciët ishte kontraktuar pretendohet se inceneratori ishte i ri, dhe kishte një garanci 5 vjeçare dhe pretendohet të mos kishte asnjë lloj aktiviteti. Normalisht po na dalin që ka difekte, administrator thot që ka 5 muaj, deklaroi që nuk punon turbina, ndërkohë që është Brenda garancisë, apo nuk ka ardhur inceneratori i ri. Dhe këtu po flitet për përgjegjësinë që kemi, sigurisht e mendoni që doni tja jepni dhe ta vazhdoni këtë rrugë, unë them që është rruga e gabuar. Të flitet për djegje për incenerim, në nuk e mbulojmë dot, a do të ketë një zgjidhje për këtë, ose bashkitë e tjera të mos na i sjellin ne mbetjet urbane dhe të punojmë me kapacitet deri në 90 ton. Ne nuk e krijuam atë incenerator për të krijuar stok të mbetjeve urbane. Nuk ekrijuam për të marrë edhe mbetjet urbane të gjithë bashkive të tjera. A kemi përgjegjësi për fëmijët tanë, për familjet e Elbasanit? Ne kemi paqartësi, dhe një pjesë e madhe janë të paqartë kaq sa mua. Kjo është llogjika që duhet të përdorim. Nuk shkon kshu, është një nga pikat më të rëndësishme pas buxhetit të shtetit. Vota jonë është kundra për çdo paqartësi. Spak zbriti dhe u dënuan dy njerëz të pafajshëm. Përgjegjësia mbetet individuale. Ju ftoj te respektoni për këtë dhe të jeni të qartë të gjithë.

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, 13 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

**V.O (Vota kundër B. Himçi, D. Madhi, E. Muzhaqi, R. Mita, D. Ceba, V. Balliu, M. Trimi, A. Marku, A. Meçja, A. Domni, N. Meta, M. Kaçuli, B.Copja)**


Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 8, 9, 10 e rendit të ditës.*

*8.Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Shpetim Lopari, banor në fshatin Gjinar, Njesia Administrative Gjinar dhe dhënien e kompensimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan;*

*9.Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Znj. Lefteri Ligor Trushi, banore në lagjen “Haxhias”, Nr. 5 dhe dhënien e kompensimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan;*

*10.Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Kristaq Kreka, banore në lagjen “11 Nëntori”, Nr. 5 dhe dhënien e kompensimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan.*

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, 1 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

V.O (Vota kundër A. Fetahu)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 11 e rendit të ditës.*

*11. Për caktimin e numrit të strukturave komunitare për çdo lagje, datën e zgjedhjeve për këshillat komunitare dhe komisionet për strukturat komunitare që do të ndjekin procesin në qytet.*

Është materiali që keni para, është hera e dytë që bëhen zgjedhjet, janë tre nga shoqëria civile, 1 administratori dhe 3 anëtarë këshilli.

### **Aurora Domni - anëtare e këshillit bashkiak**

Kush ka vendosur që duhen kaq shumë persona?

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Është një rregullore që është miratuar në këshill, kemi të bëjmë me 6 lagje dhe 4000-7000 zgjidhet një strukturë.

### **Erion Murataj – anëtarë i këshillit bashkiak**

Nga shoqëria civile kush i cakton këto emra?

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Janë kryesisht nga bashkia, por mund ta diskutojmë. Shoqëria civile janë caktuar njerëz pa përfshirje nga politika.

### **Erion Murataj – anëtarë i këshillit bashkiak**

Nuk mund të kesh tre anëtarë të shoqërisë civile që nesër për një problematikë mund të prishi balancat.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Shoqëria civile do të jetë tek komisioni që do të bëhen zgjedhjet jo tek ato që zgjidhen. Si anëtarë komisioni që do drejtojnë mbledhjen në lagje janë 7. Kështu është rregullorja.

**Dritan Cepa – anëtarë i këshillit bashkiak**

Përfaqësuesit nga shoqëria civile duhet të jenë rezident në atë rajon, ky duhet të jetë kusht përjashtues. Një anëtarë i shoqërisë civile në një rajon ku nuk është resident.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Po dhe anëtari i këshillit duhet të jetë rezident.

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala





## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 12 e rendit të ditës.*

*12.Mbi depozitimimin e inerteve dhe materialeve ndërtimore të ngurta në hapësirat e krijuara në projektin e Auto-Moto Parku-ut.*

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, - kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.O (Vota abstenim V. Balliu)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 23.02.2024, ora 10:00 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 13 e rendit të ditës.*

***13. Informacion mbi vlerësimin nxjerrjen jashtë përdorimit të disa aktiveve në QSB për vitin 2023.***

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, - kundër, - abstënim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

